

AKT-THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR PILIER HOLDING

FORMIMI

Formohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e emertuar **PILIER HOLDING** Sh.p.k. sot me daten 13.09.2024 e ortakut te vetem themelues.

1-Enver Thaqi, atësia Pajazit, amësia Kadire, shtetas Kosovar, lindur në Çifllak dhe banues në Rahovec, me adresë Çifllak Rahovec Kosove, lindur më 03/05/1976, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte Tjeter nr. P00111072 dhe nr. personal 1008189745.

S E L I A

Selia e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar **PILIER HOLDING** sh.p.k është në fshatin Gryke-Lumi, pasuria me Nr 71/4 zona kadastrale 1879, Lezhë. Ajo do te hape filiale dhe ne rrethe te tjera brenda dhe jashte vendit.

FORMA JURIDIKE

Forma juridike e shoqerise eshte Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar.

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike e shoqerise eshte e pakufizuar ne kohe.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

- Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise **PILIER HOLDING** sh.p.k. është:
- Në fushen e shit-blerjes se pasurive te paluajtshme me qellim investimi dhe zhvillimi me karakter turistik.
 - Në fushen e ndertimeve civile dhe industriale, per vete dhe per te tjeret.
 - Në fushen e ngritjes se pikave te sherbimeve, Bar- Bufe, Restorant etj.
 - Në fushen e sherbimeve Hoteliere dhe Turizmit, ne organizimin e tureve turistike.
 - Në fushen e agjensi per shitblerje dhe dhenie me qera te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme, agjensi turistike, agjensi komisionere etj.
 - Në fushen e tregtise me shumice e pakice, import –eksport i tyre
 - si dhe çdo aktivitetet te lejuar me ligj.

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themelor i shoqerise eshte 100.000 Lek, njeqind mije Leke e perbere nga 1 kuote me velere 100`000 leke si me poshte:

KONTRIBUTI I ORTAKEVE

Z. Enver Thaqi

100 % te kuotave apo 1 kuote

ORGANET DREJTUESE

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte vendimor i shoqerise dhe perbehet nga keta anetare.

Cdo anetar i asamblese ka te drejte te marre pjese ne asamble vete ose me perfaqesim dhe te beje prezent opinionin e tij. Numri i votave te çdo perfaqesuesi te asamblese eshte ne raport me pjesen etyre te kapitalit ne kapitalin themelor te shoqerise.

Shoqeria tregtare **PILIER HOLDING** sh.p.k. drejtohet nga administratori **Enver Thaqi** i cili emerohet nga asambleja e ortakeve per nje afat 5-vjecar me te drejte perseritje i cili ka te drejte qe sipas rastit te emeruje te gjithe punonjesit e shoqerise.

Ne marredheniet me te tretet Shoqeria perfaqesohet nga administratori

Ne emer te shoqerise firmos administratori i cili i bashkangjit emertimin tregetar te shoqerise emrin, mbiemrin dhe funksionin e tij.

Akti i themelimit nenshkruhet nga ortaket themelues te perfaqesuar me Prokure te Posacme Nr 5892 Rep Nr 2991 Kol date 13.09.2024 nga Merita Gjeçi

ORTAKU I VETEM THEMELUES

Enver Thaqi

I perfaqesuar me procure te posacme nga
Merita Gjeçi

